


Q



**Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“ELEKTROTEKNIKË”

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

E-IV-21

Tiranë, 2021

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	ELEKTROTEKNIKE			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	IV KSHK, referuar nivelit IV të KEK	E-IV-21
Qëllimi	Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “ Elektroteknik ”, Niveli IV KSHK , referuar nivelit IV të KEK, është: “Zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar si teknik elektrik në veprimtaritë profesionale që lidhen me drejtimin elektroteknik, të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e elektroteknikës, si dhe për të vijuar arsimin dhe formimin në nivele më të larta”.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Elektroteknike” të nivelit IV të KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> -kanë mbaruar arsimin profesional në një nga kualifikimet e nivelit III të KSHK, referuar nivelit III të KEK, në “Elektroteknikë” -Të jenë në kushte shëndetësore që e lejojnë kryerjen e detyrës për përballimin e kërkesave të këtij niveli të arsimit profesional. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional në “Elektroteknikë”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të teknikut elektrik në këtë fushë.</p> <p>Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në sektorin elektroenergjitik (prodhim, transmetim, shpërndarje), në sektorë të ndryshëm të industrisë, njësi të shërbimeve elektrike ose firma që realizojnë instalime elektrike të ndryshme, në shërbime të riparimeve e mirëmbajtjes të pajisjeve, si dhe në njësi të tjera ekonomike që ushtrojnë veprimtarinë në drejtimin e sistemeve elektroteknike, elektronike apo elementeve të tyre përbërës, si dhe ato të dimensionimit dhe menaxhimit optimal të tyre. Gjithashtu, individit mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e instalimeve elektrike të godinave civile dhe reparteve industriale.</p> <p>Me përfundimin e kualifikimit profesional “Elektroteknikë”, niveli i IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, ai/ajo fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare</p>			
Data e validimit	(kur të miratohet)			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	E-IV-15			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

Në përfundim të kualifikimit profesional në drejtimin “Elektroteknikë” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

NJOHURI PROFESIONALE

Sigurimi teknik

- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- Të listojë aksidentet kryesore që mund të ndodhin gjatë punimeve të ndryshme në fushën e elektroteknikës;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes kundër zjarrit në vendin e punës;
- Të analizojë masat mbrojtëse në varësi të punës që do kryhet për mos rënien nën tension në instalimet elektrike.
- Të interpretojë mënyrën e dhënies së ndihmës së parë në rast të goditjes nga rryma elektrike;
- Të shpjegojë veprimin e rrymës elektrike në trupin e njeriut dhe llojet e dëmtimeve që shkaktohen prej saj;
- Të analizojë metodat e kontrollit të pajisjeve, mjeteve mbrojtëse dhe aparateve të ndryshme që duhet të përdori gjatë një aktiviteti të caktuar;
- Të analizojë hapat që duhet të ndjekë për realizimin e sigurt të punës në reparte të ndryshme elektroteknike;
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së ambientit nga ndikimi i fushave magnetike dhe elektrostatische dhe masat përkatëse për eliminimin e tyre;
- Të shpjegojë mënyrën e organizimit të sektorit të energjisë elektrike dhe rolin e institucioneve të ndryshme.

Standardet

- Të shpjegojë çfarë janë standardet IEC (International Electrotechnical Commission) në Elektroteknikë;
- Të listojë standardet kryesore teknike evropiane që duhet të zbatohen në instalimet elektrike civile dhe Industriale;
- Të listojë standardet kryesore teknike evropiane që duhet të zbatohen gjatë përzgjedhjes së materialeve elektrike

Transmisione elektrike

- Të analizojë elementet e një transmisioni elektrik;
- Të analizojë karakteristikat elektrike të motorëve elektrikë;
- Të shpjegojë mënyrat e rregullimit të shpejtësisë në transmisionet elektrike;
- Të përshkruajë proceset kalimtare në transmisionet elektrike;
- Të analizojë procese të ndryshme industriale;
- Të klasifikojë procese të ndryshme industriale;
- Të shpjegojë modelimin dhe simulimin e një procesi industrial;
- Të shpjegojë madhësitë bazë të kontrollit të proceseve industriale;
- Të shpjegojë elementët përbërës dhe skemat e rregullimit industrial;
- Të vlerësojë mënyrat e ndryshme të kontrollit të proceseve të industriale;

Elektronike dhe procese automatizimi

- Të analizojë nivelet e tensionit për sinjale të portave logjike;
- Të analizojë rrjetin sinkron ose asinkron përmes linjës elektrike ose optike;
- Të përshkruajë skemat e kontrollit numerik me logjike të programueshme ;
- Të analizojë sistemin me mikroprocesore në një minifabrike ;
- Të analizojë skema me mikroprocesorë përmes funksionimit të pineve;
- Të analizojë skemat që përdoren për matjen e kapacitetit.
- Të analizojë skemat që përdoren për matjen e induktivitetit;
- Të shpjegojë parimin e punës së skemave të ndryshme të rregullimit elektronik të shpejtësisë së motorëve

Rrjeta elektrike

- Të analizojë elementët përbërës të një impianti shpërndarës të energjisë elektrike;
- Të analizojë konstruktionet për montimin e pajisjeve elektrike në instalimet elektrike;
- Të analizojë skemat elektrike të furnizimit me energji elektrike
- Të llogarisë rrymën e veprimit të pajisjeve shkyçëse të TU dhe TL;
- Të përcaktojë seksionin e përcjellësve dhe kablllove në bazë të ngarkesës së lejuar
- Të analizojë efektet e lidhjes së shkurtër;
- Të vlerësojë humbjet e fuqisë dhe energjisë në rrjet;
- Të analizojë mënyrat e rregullimit të tensionit dhe të përmirësimit të $\cos\phi$;
- Të përshkruajë rolin e baterive akumulatore;
- Të analizojë tokëzimin mbrojtës në instalimet elektrike;
- Të analizojë nulifikimin mbrojtës në instalimet elektrike;
- Të analizojë defektet e mundshme të rrjetit elektrik me dhe pa ngarkesë;

Projekt

- Të analizojë projektin të thjeshta elektrik të objekteve civile;
- Të përshkruajë projektin elektrik të objekteve industriale;
- Të vlerësojë preventivin sipas projektit duke marrë parasysh dhe kërkesat e klientit;
- Të analizojë përdorimin e skemave të ndryshme të instalimit të ndriçimit dhe fuqisë në objekte civile dhe industriale;

- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes të ngarkesës të instaluar dhe të kërkuar të objektit.

Elektroteknike

- Të shpjegojë metodat e matjes elektrike për madhësitë jo elektrike;
- Të shpjegojnë rolin e aparateve regjistruese;
- Të shpjegojnë parimin e punës së aparateve matëse analoge;
- Të shpjegojnë parimin e punës së aparateve matëse elektronike shifrore ;
- Të analizojnë sistemet matëse të informacionit në distancë;

Programe kompjuterike

- Të dallojë programet e licencuara dhe të drejtën e përdorimit;
- Të shpjegojë funksionin dhe përdorimin e çelësit “KEY” të licencimit për programet softuare AutoCad, Cad elektrik, Crocodile dhe Multisim;
- Të shpjegojë mënyrën e dizenjimit të skemave elektrike duke përdorur Tool-sat në programin AutoCad dhe AutoCad Electrical;
- Të shpjegojë funksionin dhe përdorimin e softeve të ndryshme kompjuterike në shërbim të elektroteknikës;
- Të shpjegojë mënyrën e ekzekutimit dhe testimit të skemave të ndërtuara në kompjuter me CAD elektrik dhe Crocodile.

Organizim dhe menaxhim biznesi

- Të shpjegojë rëndësinë e menaxhimit të një biznesi;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe avantazhet e sipërmarrjes në sektorin e energjisë;
- Të shpjegojë krijimin, funksionimin në treg dhe mënyrat e menaxhimit të një kompanie që operon në fushën e elektroteknikës.
- Të përshkruajë teknikat për të udhëhequr dhe menaxhuar një biznes në kontekst të kërkesave aktuale shoqërore;
- Të dallojë strukturën organizative dhe rolet përkatëse
- Të përshkruajë etapat e hartimit të një plan biznesi;
- Të shpjegojë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit);
- Të interpretojë sistemin efektiv të vlerësimit të performancës së punonjësve duke përshkruar dhe analizuar elementët e tij;
- Të shpjegojë rëndësinë e zhvillimit profesional të burimeve njerëzore në një kompani që operon në fushën e elektroteknikës.;
- Të shpjegojnë elementët e pasqyrave financiare (bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve);
- Të interpretojë rezultatet e pasqyrave financiare dhe dokumentet e tjera kontabël;
- Të vlerësojë llogaritjen e kostove, me qëllim menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare në sektorin energjetik;

Sipërmarrje dhe edukim karriere

- Të shpjegojë rolin e sipërmarrjes sociale dhe ekonomike në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme;
- Të vlerësojë mendime mbi çështje etike që lidhen me veprimtari të ndryshme ekonomike;
- Të përshkruajë bazën ligjore që i referohet veprimtarive profesionale të drejtimit elektroteknik.
- Të listojë parimet e etikës gjatë ushtrimit të veprimtarive profesionale të drejtimit elektroteknik.
- Të përshkruajë fazat e zhvillimit të biznesit në kontekstin e globalizimit;
- Të analizojë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet kryesore të karrierës personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
- Të shpjegojë konceptet financiare (dokumentet financiare, institucionet financiare..);
- Të listojë komponentët e hartimit të një buxheti;
- Të përshkruajë fazat e menaxhimit të një projekti (duke identifikuar burimet e nevojshme për një projekt të veçantë);
- Të ekzaminojë teknika mbështetëse për të menaxhuar dhe zbatuar një projekt në situata të ndryshme (Analiza SËOT, diagrama e GANT...)
- Të ilustrojë metoda të zgjidhjes së problemeve në kontekste të ndryshme;
- Të evidentojë mundësitë që ofron tregu i punës dhe kualifikimet e mëtejshme;
- Të shpjegojë përmes shembujve konceptet e eksternaliteteve dhe të mirave publike;
- Të përshkruajë konceptin e ndërmarrjeve me përgjegjësi sociale në kontekste lokale dhe globale;
- Të analizojë interesat, zotësitë dhe aftësitë personale përmes mënyrave të ndryshme përfshirë vetëvlerësimin.

Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i tij

- Të shpjegojë kuptimin për mjedisin , mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm
- Të analizojë se si ndikon veprimtaria e njeriut në mjedisin rrethues.
- Të shpjegojë burimet kryesore të mjedisit jetësor.
- Të analizojë ndikimet e mbetjeve në mjedisin jetësor
- Të shpjegojë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- Të shpjegojë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm
- Të shpjegojë sistemet e menaxhimit të mjedisit.
- Të analizojnë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të planifikojë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor.

Mbikëqyrja dhe kontrolli i punimeve për sigurimi i cilësisë

- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit vizual të të gjithë instalimit të realizuar;
- Të analizojë distancat e montimit të pajisjeve;

- Të analizojë grafikun e punimet e mirëmbajtjes së parashikuar;
- Të shpjegojë rëndësinë e inspektimeve periodike të nevojshme;
- Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të rezultateve të inspektimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së pastrimit dhe lubrifikimit të pajisjeve;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të kalibrimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të orëve të punës të pjesëve ose tërësinë e pajisjes, sipas manualeve;
- Të shpjegojë rëndësinë e kryerjes së testeve funksionale të të gjitha pajisjeve të instaluar;
- Të shpjegojë rëndësinë e kryerjes së testeve të Komisionimit për pajisjet si:
 - Matjen e rezistencës së izolacionit
 - Matjen e rezistencës së tokwzimit
 - Matjen e rrymave etj.

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Sigurimi teknik

- Të zbatojë masat mbrojtëse për mos rënien nën tension në instalimet elektrike
- Të japë ndihmën e parë në rast të goditjes nga rryma elektrike;
- Të zbatojë sipas veçorive të sektorit profesional, ligjshmërinë, rregullat e përgjithshme dhe rekomandimet për mbrojtjen individuale dhe kolektive të punëtoreve;
- Të zbatojë normat kryesore të RST (rregullat e sigurimit teknik) në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Të zbatojë standardet kryesore teknike evropiane në instalimet elektrike civile dhe industriale;
- Të kontrollojë mjetet mbrojtëse, veglat, pajisjet dhe aparatet që do të përdorë për punë në instalimet elektrike civile dhe industriale;
- Të përdorë veglat, pajisjet, mjetet mbrojtëse gjatë punës në instalimet elektrike civile dhe industriale;
- Të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike, me qëllim parandalimin e aksidenteve në vendin e punës;
- Të respektojë rregullat e sjelljes dhe të lëvizjes në vendin e punës;
- Të respektojë ligjshmërinë në fushën e elektro-teknologjisë në vend;

Standardet

- Të zbatojë standardet IEC (International Electrotechnical Commission) në Elektroteknikë;
- Të zbatojë standardet kryesore teknike evropiane gjatë punës në instalimet elektrike civile dhe industriale;
- Të zbatojë standardet kryesore teknike evropiane gjatë përzgjedhjes së materialeve elektrike;

Transmisione elektrike

- Të përzgjedhë elementet e një transmisioni elektrik;
- Të realizojë në mënyra të ndryshme rregullimin e shpejtësisë në transmisionet elektrike;
- Të përzgjedhë elementet përbërës në skemat e rregullimit industrial;
- Të modelojë dhe simulojë një proces industrial;
- Të realizojë kontrollin e madhësive bazë të një procesi industrial;

Rrjeta elektrike

- Të përzgjedhë elementët përbërës të një impianti shpërndarës të energjisë elektrike;
- Të përzgjedhë konstruktionet për montimin e pajisjeve elektrike në instalimet elektrike civile dhe industriale
- Të përdorë mjetet mbrojtëse në instalimet elektrike civile dhe industriale;
- Të përdorë veglat e punës , pajisjet dhe aparatet që nevojiten në instalimet elektrike;
- Të përzgjedhë materialet përcjellëse dhe izoluese në instalimet elektrike sipas rrymës së veprimit të pajisjeve shkyçëse të TU;
- Të përcaktojë seksionin e përcjellësve dhe kabllorëve në bazë të ngarkesës së lejuar
- Të kryejë tarimin e mbrojtjeve të ndryshme;
- Te kontrollojë impiantin e tokëzimit.
- Të kryejë provat dhe kolaudimin e pajisjeve elektrike të objektit ku punon
- Të përcaktojë shkaqet e defekteve në pajisjet elektrike;
- Të eliminojë defektet në pajisjet elektrike;
- Të montojë tokëzimin mbrojtës dhe të mbrojtjes atmosferike në një objekt
- Të montojë nulifikimin mbrojtës në instalimet elektrike;
- Të montojë skemat elektrike të furnizimit me energji elektrike;
- Të llogaritë humbjet e fuqisë dhe energjisë në rrjet;
- Të realizojë rregullimin e tensionit dhe të përmirësojë cos ϕ në mënyra të ndryshme;
- Të mirëmbajë bateritë akumulatore;

Projekt

- Të hartojë një projekt të thjeshtë elektrik të objekteve civile;
- Të zbatojë projektin elektrik të objekteve industriale nën mbikëqyrje;
- Të hartojë preventivin sipas projektit duke marrë parasysh dhe kërkesat e klientit;
- Të hartojë skema të ndryshme të instalimit të ndriçimit dhe fuqisë në objekte civile dhe industriale;
- Të llogarisë ngarkesën e instaluar dhe të kërkuar të objektit

Përcaktimi dhe eliminimi i defektit

- Të përcaktojë defektet e mundshme të rrjetit elektrik.
- Të kryejë dhe të interpretojë matjet e nevojshme duke iu referuar dokumentacionit të

pajisjes;

- Të përdorë dokumentacionin teknik, manuale përdorimi dhe mirëmbajtjeje, katalogë etj., dhe skemat që kanë të bëjnë me pajisjen në fjalë;
- Të identifikojë defektin e pajisjeve të ndryshme;
- Të përcaktojë pjesën e defektuar në një skemë komplekse elektrike (pjesa e komandimit, mbrojtjes, sinjalizimit, fuqisë, etj.);
- Të eliminojë defektet e mundshme në pajisjet dhe rrjetin elektrik.
- Të plotësojë dokumentacione teknike të shërbimeve të kryera;

Elektronike dhe procese automatizimi

- Të përshtatë nivelet e tensionit për sinjale të portave logjike;
- Të montojë rrjetin sinkron ose asinkron përmes linjës elektrike ose optike;
- Të montojë skemat e kontrollit numerik me logjikë të programueshme ;
- Të instalojë sistemin me mikroprocesore në një minifabrikë ;
- Të montojë skemë me mikroprocesorë përmes funksionimit të pineve;
- Të montojë skemat që përdoren për matjen e kapacitetit.;
- Të montojë skemat që përdoren për matjen e induktivitetit;
- Të montojë skemë të ndryshme të rregullimit elektronik të shpejtësisë së motorëve;

Programe kompjuterike

- Të instalojë çelësin "KEY" të licencimit për programet software AutoCad, Cad elektrik dhe Crocodile dhe Multisim
- Të kryejë dizajnime të skemave elektrike duke përdorur Tool-sat në programin AutoCad dhe AutoCad Electrical;
- Të ndërtojë skemë elektrike me CAD elektrik dhe Crocodile ;
- Të testojë (ekzekutojë) skemat e ndërtuara në programet e simulimit për qarqet si: Multisim etj. për rezultate të sigurta të qarqeve elektrike;
- Të kryejë vizatimin e skemave, planeve të ndryshme të projektit elektrik duke përdorur programin AutoCad, Cad elektrik dhe Crocodile ;
- Të ndërtojë skemë elektrike me CAD elektrik dhe Crocodile;

Komunikimi me të tjerët dhe karriera

- Të zbatojë parimet e etikës profesionale për një komunikim efektiv me klientët dhe kolegët në ndërmarrje të ndryshme;
- Të menaxhojë situata të vështira dhe të veçanta si me klientët edhe me personelin
- Të raportojë rregullisht tek eprorët për të gjitha komentet, kërkesat dhe ankesat e klientëve;
- Të mbikëqyrë stafin profesional, për të promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës

Menaxhim biznesi

- Të zbatojë teknikat e menaxhimit.
- Të përdorë rezultatet e pasqyrave financiare (bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve), si matës të suksesit të kompanisë;
- Të mbikëqyrë mbarëvajtjen e punëve të punonjësve në një njësi punë;
- Të monitorojë performancën e personelit;
- Të vlerësojë gjendjen e furnizimit me lende të para, pajisje e mjete pune;
- Të planifikojë nevojat për burime njerëzore shtesë sipas sektorëve;
- Të identifikojë nevojat për trajnim të personelit;
- Të planifikojë zhvillimin profesional të personelit në bashkëpunim me eprorët;
- Të demonstrojë aftësi organizuese në punët në grup;
- Të specifikojë detyrat e personelit vartës sipas sektorëve;
- Të promovojë ndërmarrjen dhe aktivitetin e saj nëpërmjet materialeve të shkruara informative dhe prezantimeve elektronike; (rrjetet sociale)
- Të menaxhojë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës.
- Të vlerësojë nevojën marketingut në biznes, si dhe mënyrën për të arritur objektivat e tij;
- Të zbatojë konceptet financiare dhe mjetet e përdorura për menaxhimin financiar.
- Të zbatojë legjislacionin për krijimin e një ndërmarrjeje dhe të plotësojë dokumentacionin bazë.

Sipërmarrje

- Të demonstrojë aftësi për të zhvilluar një projekt ide sipërmarrëse (për të zhvilluar dhe zbatuar një buxhet të caktuar)
- Të zbatojë, respektojë bazën ligjore që i referohet veprimtarive profesionale të drejtimit elektroteknik.
- Të përdorë metoda dhe teknika të ndryshme të zbatimit të një projekti;
- Të analizoje të dhëna për të marrë vendimet e duhura në kontekste të ndryshme;
- Të identifikojë dhe të zgjidhë problem në mënyrë krijuese;
- Të negociojë ide me të tjerët në mënyrë efektive;
- Të demonstrojë aftësi për të njohur dhe vlerësuar risqet;
- Të demonstrojë aftësi për të planifikuar, bërë, kontrolluar dhe vepruar me qëllim për t'u vetë-përmirësuar;
- Të vlerësojë potencialin personal (aftësitë personale, sociale dhe për biznes, njohuritë e mëparshme..) për të shfrytëzuar avantazhin konkurrues;
- Të demonstrojë aftësi udhëheqëse në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të aplikuar parimet e ekonomisë së lirë të tregut në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të motivuar dhe inkurajuar të tjerët në arritjen e synimeve të tyre;
- Të aplikojë aftësitë për planifikim dhe menaxhim projekti në situata të ndryshme;
- Të sigurojë burime e duhura dhe të marrë përgjegjësinë për t'u kujdesuar për to.

- Të menaxhojë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës.
- Të hartojë një plan efektiv biznesi sipas profilit përkatës;

Mbrojtja e mjedisit

- Të kujdeset për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm
- Të riciklojë mbetjet e prodhimit në mjedisin jetësor
- Të përdorë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore.
- Të zbatojë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm
- Të zgjidhë problemet mjedisore në mjedisin vendor.
- Të realizojë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor

Mbikëqyrja dhe kontrolli i punimeve për sigurimi i cilësisë

- Të kryejë kontrollin vizual të të gjithë instalimit të realizuar;
- Të kontrollojë distancat e montimit të pajisjeve;
- Të kryejë rregullisht punimet e mirëmbajtjes së parashikuar;
- Të inspektojë në mënyrë periodike pajisjet;
- Të dokumentojë rregullisht rezultatet e inspektimit;
- Të mbikëqyrë kryerjen e pastrimit dhe lubrifikimit periodik;
- Të mbikëqyrë rregullisht kryerjen e kalibrimit;
- Të mbikëqyrë kryerjen e ndërrimit në intervalet e caktuara pjesët ose tërësinë e pajisjes sipas manualeve;
- Të kryejë testet funksionale të të gjitha pajisjeve të instaluara;
- Të kryejë testet e Komisionimit për pajisjet si:
 - Matjen e rezistencës së izolacionit
 - Matjen e rezistencës së tokëzimit
 - Matjen e rrymave etj.

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme

- në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
 - Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
 - Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
 - Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
 - të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
 - Të vlerësojë dhe vetë vlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.
 - Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
 - Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
 - Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
 - Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
 - Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
 - Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
 - Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;
 - Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
 - Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.